



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201901386/4

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2020

**Lënda:** Rekomandim për ndryshim legjislativ për të garantuar të drejtën e fëmijës për t'u arsimuar

**MINISTRISË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË**

*Për dijeni:*

**AGJENSISË SHTETËRORE PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS**

**TIRANË**

Të nderuar,

Më lejoni, që nëpërmjet këtij komunikimi, të ndaj me Ju shqetësimin, e bërë prezent nga zyra rajonale Fier e institucionit të Avokatit të Popullit, lidhur me ankesën e nxënësit/maturantit X.X., për garantimin e së drejtës për arsim, pa kufizime.

Në këtë ankesë parashtrohet shqetësimi, se nxënësit që ndjekin gjimnazin "Janaq Kilica" në qytetin e Fierit, konkretisht ata që përdorin linjën e transportit publik Shtyllas-Levan-Fier, kërkojnë vendosjen e linjës së autobusave të shkollës, që t'u mundësojë atyre një akses të lehtë dhe të sigurt në ndjekjen e frekuentimin e mësimi në këtë gjimnaz.

Në mbështetje të nenit 13, të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, Avokati i Popullit filloi procedurën e shqyrtimit të çështjes, bazuar në të drejtën e fëmijës për t'u dëgjuar, nëpërmjet së cilës, çdo fëmije i garantohet e drejta për

t'u dëgjuar vetë ose nëpërmjet prindit, kujdestarit, ose përfaqësuesit në të gjitha proceset administrative e gjyqësore që lidhen me të, sipas rregullave procedurale për këtë qëllim.

Nëse autoritetet refuzojnë të marrin mendimin e fëmijës, në çdo rast duhet dhënë vendim i arsyetuar për shkaqet e refuzimit. Po kështu e drejta e fëmijës për t'u dëgjuar respektohet nga autoritetet shtetërore gjatë proceseve vendimmarrëse, që lidhen me hartimin e politikave dhe akteve ligjore dhe nënligjore, që rregullojnë dhe mundësojnë garantimin e të drejtave dhe mbrojtjen e fëmijës<sup>1</sup>.

Në mbështetje të legjislacionit në fuqi, "fëmijë" është çdo person nën moshën 18 vjeç<sup>2</sup>. Çdo fëmije brenda territorit të RSH-së, duhet t'i ofrohet një arsim cilësor e i denjë, në të cilin interesi i nxënësit është parësor, në veprimtaritë e institucioneve të sistemit arsimor parauniversitar<sup>3</sup>.

Në këtë kuptim, fëmija ka të drejtën e aksesit dhe të frekuentimit të arsimimit falas e cilësor, në bazë të mundësive të barabarta dhe pa diskriminim, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar. Kjo e drejtë i garantohet edhe fëmijës, që dëshiron të vazhdojë të arsimohet pas përfundimit të arsimit të detyrueshëm<sup>4</sup>.

Ndërkaq, institucionet përgjegjëse duhet të marrin masa konkrete për ofrimin e shërbimeve sociale brenda mjediseve të shkollës, si ushqim, transport e të tjera, me qëllim parandalimin e braktisjes së shkollës për arsye ekonomike<sup>5</sup>.

Në zbatim të shkronjës "b", të nenit 19, të ligjit nr. 8454, datë 4.2.1999, "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, si dhe në përmbushje të kompetencave të tij kushtetuese, për mbledhjen e informacionit dhe dokumentacionit, në rastet e procedurës hetimore administrative, Avokati i Popullit kërkoi informacion zyrtar nga Bashkia Fier dhe Zyra Vendore Arsimore Fier.

Në përfundim të procesit hetimor administrativ, institucioni i Avokatit të Popullit, në vlerësim të informacionit të gjeneruar, për rastin në fjalë konstaton se:

- fëmijët/nxënësit e gjimnazit "Janaq Kilica", me vendbanim në Shyllas, Njësia Administrative Levan, kanë mundësi të ndjekin linjën e transportit publik të udhëtarëve në itinerarin Shtyllas-Levan-Fier<sup>6</sup>.
- në mbështetje të ligjit nr.69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, arsimi i mesëm i lartë nuk përfshihet në arsimin e detyruar dhe, nxënësit duhet të regjistrohen në shkollën më të afërt me

<sup>1</sup> Pika 1, e 2, e nenit 13, të ligjit nr. 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".

<sup>2</sup> Pika 4, e nenit 3, të ligjit nr. 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".

<sup>3</sup> Pika 1, e nenit 6, të ligjit nr. 69/2012 "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

<sup>4</sup> Pika 1, e nenit 18, të ligjit nr. 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".

<sup>5</sup> Shkronj "dh", e pikës 3, të nenit 18, të ligjit nr. 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".

<sup>6</sup> Shkresa zyrtare me nr.2101/1 prot., datë 5.3.2020 e Bashkisë Fier.

vendbanimin e tyre, duke respektuar hartën territoriale të përcaktuar. Po kështu, në bazë të vendimit nr.682, datë 29.7.2015, të Këshillit të Ministrave “Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”, ky nivel arsimor nuk përfiton transport<sup>7</sup>.

Kjo problematikë, është në vijimësi, pasi me rinisjen e procesit arsimor në përfundim të masave të karantinës, për shkak të pandemisë, shkaktuar nga virusi Covid-19, edhe një grup nxënësish/maturantët në qarkun e Elbasanit, u bërballën me pamundësinë e frekuentimit të rregullt të mësimi si shkak i mungesës së transportit urban<sup>8</sup>.

Në Republikën e Shqipërisë garantohet e drejta për arsimimin e shtetasve shqiptarë, të huaj dhe personave pa shtetësi, pa u diskriminuar nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, orientimi seksual, bindjet politike ose fetare, gjendja, ekonomike apo sociale, moshë, vendbanimi, aftësia e kufizuar ose për arsye të tjera që përcaktohen në legjisllacionin shqiptar. Sjellim në vëmendje, se në shkollat publike, arsimit të detyrueshëm dhe arsimit të mesëm të lartë janë falas<sup>9</sup> dhe gjithëpërfshirës.

Arsimi gjithëpërfshirës është një proces i forcimit të kapaciteteve të sistemit arsimor për të mbuluar të gjithë nxënësit dhe, si pasojë, mund të kuptohet si një strategji kyçe për arritjen e arsimit për gjithkënd. Si një parim i përgjithshëm, ai duhet të udhëheq të gjitha politikat dhe praktikat arsimore, duke vlerësuar, se arsimit është një e drejtë bazike e njeriut dhe themeli për një shoqëri më të drejtë dhe të barabartë.

Në këtë frymë, shkronja “b”, e pikës 1, të vendimit nr.682, datë 29.7.2015, të Këshillit të Ministrave “Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimor që punojnë dhe nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”, nuk është gjithëpërfshirëse e për më tepër, ajo nuk reflekton qartësisht detyrimin kushtetues<sup>10</sup>, sipas të cilit, arsimit të mesëm të përgjithshëm është i hapur për të gjithë fëmijët, të cilët kanë interes për të vazhduar edukimin në institucionet përkatëse të arsimit të mesëm të lartë, në përputhje me aftësitë dhe prirjet e tyre.

Në funksion të zbatimit të parimit të interesit më të lartë të fëmijës, për t’i ofruar një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, shtetet inkurajojnë zhvillimin e formave të ndryshme të arsimit të mesëm të përgjithshëm dhe profesional, i bëjnë ato të hapura e të arritshme e të mundshme për çdo fëmijë, duke marrë masa të përshtatshme, për vendosjen e arsimit falas dhe dhënien e një ndihme financiare, në rast

<sup>7</sup> Shkresa Zyrtare me nr.525/1 prot., datë 16.12.2019 e Zyrës Vendore Arsimore Fier..

<sup>8</sup> Rast i trajtuar me iniciativë nr. dok 20201821, ”Mungesa e transportit për maturantët në qytetin e Elbasanit”.

<sup>9</sup> Pika 1, e 2, e nenit 5, të ligjit nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

<sup>10</sup> Pika 3, e nenit 57, i Kushtetutës së RSH-së.

nevoje si dhe nxisin për frekuentimin e rregullt të shkollës dhe uljen e përqindjes së braktisjes së saj<sup>11</sup>.

Për të bërë të mundur harmonizimin e asaj pjese të legjislacionit, që afekton në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo, të drejtat e fëmijëve dhe, në rastin konkret, të drejtën e fëmijës për t'u arsimuar, bazuar në parimin e interesit më të lartë të tij, si dhe garantimin e ushtrimit të kësaj të drejte, në mbështetje të nenit 21 dhe 24, shkronja "a", të ligjit nr.8454, datë 4.2.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, institucioni i Avokati i Popullit:

### **REKOMANDON:**

- Marrjen e masave nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, për rishikimin e vendimit nr.682, datë 29.7.2015, të Këshillit të Ministrave "Për përdorimin e fondeve publike për transportin e punonjësve arsimor që punojnë dhe nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit", me qëllim përfshirjen e nxënësve të arsimit të mesëm të lartë në përfitimin e transportit falas nga fondet publike, si një e drejtë kushtetuese, për t'u garantuar kështu, kësaj kategorie ndjekjen dhe frekuentimin e arsimit të mesëm të përgjithshëm, pa barriera dhe diskriminim

Në mbështetje të nenit 22, të ligjit nr. 8454 datë 4. 2.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandime, duhet t'i shqyrtojnë ato dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit, ndërmjet institucioneve tona, në frymën e legjislacionit të ri të mbrojtjes së fëmijës, drejt qasjes së bashkërendimit dhe koordinimit ndërsektorial në nivel qendror dhe vendor, si dhe në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, lutemi shqyrtimin e këtij rekomandimi.

## **K O M I S I O N E R**

**Nejla PEKA**

---

<sup>11</sup> Shkronjat "b" dhe "e", të pikës 1, të nenit 28, të "Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës", miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, 20 nëntor 1989.

